



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE

Nr. 14199 prot.

Vlorë, më 14.11 2023

PROJEKT -VENDIM

Nr. _____ , datë ____ . ____ . 2023

PËR

MIRATIMIN E VLERËS FINANCIARE TË DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA DJEGIA E BANESËS TË Z. ERJON JONUZAJ, ARTAN JONUZAJ DHE LUTFIE FANAJ, DHE SHPËRBLIMIN FINANCIAR NGA ANA E BASHKISË VLORË.

Këshilli i Bashkisë Vlorë në zbatim të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 8 pika 2, neni 9/1 pika b, neni 29/1, neni 54 pika dh ,të ligjit nr.45/2019 datë 18.07.2019 “Për mbrojtjen civile”,në VKM Nr. 329 data 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore” paragrafi III/ë dhe pika 3/a, pasi mori në shqyrtim materialin e përgatitur nga Drejtoria e Mbrojtjes Civile, Drejtoria e Financës dhe Këshilli i Qarkut Vlorë,

VENDOSI:

1. Të miratojë vlerën financiare të dëmeve të shkaktuara nga djegia në banesën e z.Erjon Jonuzaj, e ndodhur në lagjen “1 Maji”, Rajoni Nr.4, Bashkia Vlorë, në datën 16.06.2023, sipas preventivit të hartuar nga ekspertët e Këshillit të Qarkut Vlorë përkatësisht në masën:

- 144.984(njëqind e dyzet e katër mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e katër) lekë për punime ndërtimi. (298.968x50%)

● 319.024(treqind e nëntëmbëdhjet mijë e njëzet e katër) lekë për mobilje dhe pajisje elektroshtëpiake

2. Të miratojë vlerën financiare të dëmeve të shkaktuara nga djegia në banesën e z.Artan Jonuzaj, e ndodhur në lagjen “Hajro Çakëri”, Rajoni Nr.1, Bashkia Vlorë, në datën 07.07.2023, sipas preventivit të hartuar nga ekspertët e Këshillit të Qarkut Vlorë përkatësisht në masën:

● 302.051(treqind e dy mijë e pesëdhjetë e një) lekë për punime ndërtimi (604.103x50%).
● 524.051(pesëqind e njëzet e katër mijë e pesëdhjetë e një) lekë për mobilje dhe pajisje elektroshtëpiake.

3. . Të miratojë vlerën financiare të dëmeve të shkaktuara nga djegia në banesën e z.Lutfie Fanaj, e ndodhur në “Llakatund”, Njësia Administrative Shushicë, Bashkia Vlorë, në datën 29.04.2023, sipas preventivit të hartuar nga ekspertët e Këshillit të Qarkut Vlorë përkatësisht në masën

● 349.935(treqind e dyzet e nëntë mijë e nëntëqind e tridhjet e pesë) lekë për punime ndërtimi (699.870x50%).

●239.626(dyqind e tridhjet e nëntë mijë e gjashtëqind e njëzet e gjashtë) lekë për mobilje dhe pajisje elektroshtëpiake.

- Shpërblimi financiar do të përballohet nga fondi i emergjencave civile të Bashkisë Vlorë.
- Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financë-Buxhetit dhe Drejtoria e Mbrojtjes Civile pranë Bashkisë Vlorë.
- Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015,neni 55 pika .

Koncept: O.Bejto

Miratoi: A.Spaho

KRYETARI

Ermal DREDHA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE

Nr. 14199/1 prot.

Vlorë, më 14.11 2023

RELACION

PËR

PROJEKT-VENDIMIN “PËR MIRATIMIN E VLERËS FINANCIARE TË DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA DJEGIA NË BANESËN E Z.ERJON JONUZAJ, ARTAN JONUZAJ DHE LUTFIE FANAJ DHE SHPËRBLIMI FINANCIAR NGA ANA E BASHKISË VLORË “

Në zbatim të VKM Nr. 329 datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”.

Komisioni i Bashkisë Vlorë i ngritur me Urdhërin e Brendshëm Nr.301 datë 08.09.2023 të Kryetarit të Bashkisë Vlorë ,shkoi në banesë për të konstatuar dëmet e shkaktuara nga djegia.

1- z.Erjon Jonuzaj në datën 21.06.2023 ka paraqitur kërkesën me Nr.7452 prot, për shkak të djegies së banesës e ndodhur në lagjen "1 Maji", Rajoni Nr.4, Bashkia Vlorë.

Mbas hartimit të proces-verbalit të konstatimit të gjendjes së banesës në datë 29.06.2023, është vijuar me shkresën përcjellëse me Nr.7452/1 prot, datë 19.09.2023 Dërgohet dokumentacioni për banesën e djegur të z.Erjon Jonuzaj, në Këshillin e Qarkut Vlorë për të vazhduar me preventivat e vlerësimit të dëmeve nga komisioni i ekspertëve.

Këshilli i Qarkut Vlorë me shkresën Nr.7452/2, datë 13.10.2023 “Dërgim preventivi dhe dokumentacioni i banesës së djegur të z. Erjon Jonuzaj ka dërguar preventivin e hartuar nga komisioni i ekspertëve, nga ku rezulton:

- Vlera e dëmeve në banesën e z.Erjon Jonuzaj është 464.008(katërqind e gjashtëdhjet e katër mijë e tetë) lekë.

2- Artan Jonuzaj në datën 07.07.2023 ka paraqitur kërkesën me Nr.8345 prot, për shkak të djegies së banesës e ndodhur në lagjen “Hajro Çakërri”, Rajoni Nr 1, Bashkia Vlorë.

Mbas hartimit të proces-verbalit të konstatimit të gjendjes së banesës në datë 10.07.2023, është vijuar me shkresën përcjellëse me Nr.8345/1 prot, datë 19.09.2023 Dërgohet dokumentacioni për banesën e djegur të z.Artan Jonuzaj, në Këshillin e Qarkut Vlorë për të vazhduar me preventivat e vlerësimit të dëmeve nga komisioni i ekspertëve.

Këshilli i Qarkut Vlorë me shkresën Nr.8345/2, datë 13.10.2023 “Dërgim preventivi dhe dokumentacioni i banesës së djegur të z.Artan Jonuzaj ka dërguar preventivin e hartuar nga komisioni i ekspertëve, nga ku rezulton:

- Vlera e dëmeve në banesën e z.Artan Jonuzaj është 826.102 (tetëqind e njëzet e gjashtë mijë e njëqind e dy) lekë.

3- Lutfie Fanaj në datën 06.09.2023 ka paraqitur kërkesën me Nr.10366 prot, për shkak të djegies së banesës e ndodhur në “Llakatund”,Njësia Administrative Shushicë, Bashkia Vlorë.

Mbas hartimit të proces-verbalit të konstatimit të gjendjes së banesës në datë 13.09.2023, është vijuar me shkresën përcjellëse me Nr.10366/1 prot, datë 19.09.2023 Dërgohet dokumentacioni për banesën e djegur të znj.Lutfie Fanaj, në Këshillin e Qarkut Vlorë për të vazhduar me preventivat e vlerësimit të dëmeve nga komisioni i ekspertëve.

Këshilli i Qarkut Vlorë me shkresën Nr.10366/2, datë 13.10.2023 “Dërgim preventivi dhe dokumentacioni i banesës së djegur të znj.Lutfie Fanaj ka dërguar preventivin e hartuar nga komisioni i ekspertëve, nga ku rezulton:

- Vlera e dëmeve në banesën e znj.Lutfie Fanaj është 589.561 (pesëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e një) lekë.

Aktualisht Bashkia Vlorë ka mundësi financiare për të ndihmuar familjet për banesat e djegura.

Për sa më lart i kërkojmë Këshillit të Bashkisë të miratojë vlerën financiare të dëmeve të shkaktuara nga djegia në banesat e z.Erjon Jonuzaj, Artan Jonuzaj dhe Lutfie Fanaj sipas preventivit të hartuar nga ekspertët e Këshillit të Qarkut Vlorë dhe shpërblimin financiar i cili do të përballohet nga fondi i Emergjencave Civile i Bashkisë Vlorë

DREJTORI I MBROJTJES CIVILE

Aulon SPAHO

Koncept: E.Kamberi

Pranoi: O.Bejto